



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government  
Ministria e Mbrojtjes  
Ministarstvo za Odbrane / Ministry Of Defense



# RAPORTI VJETOR I MINISTRISË SË MBROJTJES 2024

Prishtinë, 2025

Qëllimet strategjike të Ministrit të Mbrojtjes 2021-2025 .....	3
Arritjet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2024 .....	4
Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe sigurisë gjatë vitit 2024 .....	6
Aktivitetet Ndërkombëtare dhe takimet kryesore të Ministrit të Mbrojtjes brenda vitit .....	7
Kosova anëtar i asocuar i Asamblesë Parlamentare të NATO-s .....	8
Kosova zyrtarisht pjesë e Koalicionit të Deminimit për Ukrainën .....	9
FSK i bashkëngjitet Operacionit Interflex për trajnimin e ushtarakëve ukrainas .....	10
Republika e Kosovës dhe Republika e Turqisë nënshkruajnë Marrëveshje .....	
Ushtarake Kornizë .....	11
Marrëveshje historike mes Kosovës dhe Gjermanisë për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë .....	12
FSK tregon sukses të lartë në ushtrimin “EFES 2024” në Turqi .....	13
Konferenca Ndërkombëtare “FSK dhe Partnerët 2024” forcon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe sigurinë rajonale .....	14
Kosova dhe Turqia me kontratë për ngritjen e fabrikës së municioneve .....	15
Arritjet në dokumentet strategjike të Mbrojtjes së Kosovës për 2024 .....	16
Roli Strategjik i DPV në Zhvillimin e Politikave të Mbrojtjes dhe Sigurisë .....	17
Avancimi i diplomacisë së mbrojtjes dhe integriteteve ndërkombëtare të Kosovës .....	18
Rritje e buxhetit për Ministrinë e Mbrojtjes në vitin 2025 në rreth 208 milionë euro .....	19
Përkushtimi për komunikim transparent dhe rritja e besueshmërisë së FSK-së .....	20
Suksesi dhe efikasiteti në organizimin e aktiviteteve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së .....	21
Përparime të mëdha në deminimin humanitar në Kosovë .....	22
Efikasiteti i Departamentit të Prokurimit dhe Kontratave gjatë vitit .....	23
Iniciativa ligjore dhe marrëveshjet strategjike .....	24
Miratohet në qeverinë e Republikës së Kosovës Programi Kombëtar për Mbrojtjen Gjithëpërfshirëse .....	25
Avancimi i të Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes .....	26
Strategjia dhe suksesi në integrimin e komuniteteve jo-shumicë në Ministrinë e Mbrojtjes .....	27
Përparimi i FSK-së në rritjen profesionale dhe modernizimin e pajisjeve .....	28
Në FSK gjatë vitit 2024 janë pranuar 346 rekrutë dhe në proces rekrutimi janë 390 kandidatë të tjerë .....	29
Arritjet vjetore të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së dhe Marrëveshja për Shkëmbim Kadetësh me Kanadanë .....	30
Departamenti për Menaxhimin e Karrierës dhe Verifikimin- Arritjet kryesore për vitin 2024 .....	31
Donacionet dhe forcimi i kapaciteteve të FSK-së .....	32
Ministria e Mbrojtjes dhe FSK marrin në menaxhim pronat e Aeroportit Dumosh .....	33
Inaugurimi i Qendrës Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike .....	34
Bashkëpunimet e MM-së dhe FSK-së për ngritjen e shërbimeve mjekësore .....	35
Përmirësimi i Sigurisë dhe Informacionit përmes projekteve të sigurisë për MM dhe FSK .....	36
Përmirësimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes .....	37

## QËLLIMET STRATEGJIKE TË MINISTRIT TË MBROJTJES 2021-2025

Politikat qeveritare të mbrojtjes dhe avancimi i rolit dhe përgjegjësive të Forcave të Sigurisë së Kosovës, gjatë vitit 2024 janë bazuar në katër objektiva kryesore:

1. Fuqizimi i mbikëqyrjes demokratike civile, si dhe rritja e llogaridhënies dhe transparencës.
2. Zhvillimi i kapaciteteve ushtarake në funksion të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial.
3. Zgjerimi i bashkëpunimit bilateral, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në operacione jashtë vendit.
4. Mbajtja dhe zhvilli i kapaciteteve thelbësore për mbështetjen ushtarake të autoriteteve civile.

Në këtë raport vjetor, janë përmbledhur arritjet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes gjatë vitit 2024, duke pasqyruar angazhimet dhe përparësitë në përmbushjen e këtyre objektivave strategjike.

## Arritjet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2024



Ministria e Mbrojtjes, përkatësisht ushtria e Republikës së Kosovës që nga fillimi ka qenë dhe po vazhdon të mbetet ndër prioritetet kryesore të kryeministrit Kurti dhe qeverisë tonë. Kjo dëshmohet mbi të gjitha me ndarjet buxhetore që për herë të parë arrin mbi 2% të BPV (Bruto Produktit Vendor), duke plotësuar kështu edhe njërin nga standardet e NATO-s.

Buxheti rekord i ndarë për Ministrinë e Mbrojtjes ka ndikuar në zhvillimin me hapa të jashtëzakonshëm të ushtrisë sonë duke ngritur kapacitetet në tre aspekte kyqe: arsenalin ushtarak, personelin numerikisht dhe ndërtimin profesional të tyre përmes trajnimeve.

Rekrutuam deri më tani 1971 ushtarakë të rinj, ndërsa jemi në proces të rekrutimit dhe të 600 ushtarëve, duke dërguar në total numrin e të rekrutuarve gjatë katër viteve në 2571, apo në raport krahasimor kemi arritur të dyfishojmë numrin e ushtarakëve brenda një mandati.

Krahas rritjes në numër, kemi mbështetur dhe rritjen e mirëqenies së pjesëtarëve të FSK-së përmes ngritjes së pagave, ashtu që ushtari i klasit të parë nga 422 euro sa paguhej më parë, tani merr një pagë prej 616 euro. Dhe nuk ndodhën zhvillime vetëm sa i përket pagave, por investuam dhe në përgatitjen profesionale të tyre përmes financimit të shkollimeve dhe trajnimeve.

Që nga fillimi i mandatit janë shkolluar qindra oficerë dhe dhjetëra kadetë në akademitë ushtarake më të njohura në botë, ndërsa janë trajnuar jashtë vendit 4011 ushtarakë, që është shumëfish më shumë se në qeverisjet e kaluara. Në të njëjtën kohë kemi investuar në ngritjen e kapaciteteve luftarake përmes blerjes së sistemeve të armatimit.

Me një buxhet që ka shënuar trefishim, janë investuar rreth 319 milionë euro, që është dallim i jashtëzakonshëm në raport me periudhën trevjeçare të qeverisjes së kaluar që kishte investuar më pak se 4 milionë në këtë drejtim.

Dronët Bayraktar janë vetëm një nga llojet e sistemeve moderne të

armatimeve të cilat tanimë i kemi në dispozicion, ndërsa jemi në proces të ekzekutimit të pagesave për blerjen e sistemit amerikan raketor anti-tank "Javelin".

Gjithashtu është nënshkruar kontrata me kompaninë shtetërore turke për ndërtimin e fabrikës së municionit, që do të funksionojë si ndërmarrje publike me prodhime "Made in Kosova".

Nuk mund të mos përmend faktin që gjatë këtij është realizuar për herë të parë në vend Kursi Bazik i Oficerëve të Këmbësisë nga FSK, si dhe pjesëmarrja në 12 ushtrime ndërkombëtare (Winter Exercise, Combined Resolve, KFOR 32,33,34, Dynamic Front 24, Eager Lion 24, EFES 24, Vigoros Warrior 24, Dimali 24, Defender Europe 21 e 23) me ç'rast është validuar një regjiment.

Po ashtu pjesëtarët tanë kanë treguar shkallë të lartë profesionalizmi në operacionin e kërkim-shpëtimit të iniciuar me rastin e tërmetit në Turqi, pastaj në operacionin e bashkë zbarkimit në Ishujt Falkland.

Në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar më duhet të theksoj se kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 15 shtete, ndërsa jemi në proces të dakordimit për MoU me Republikën Çeke, Bullgarinë dhe Finlandën.

Po ashtu, gjatë këtij viti kemi zgjeruar rrjetin e diplomacisë ushtarake përmes akreditimit të atashëve tanë ushtarak në Holandë, Slloveni Kanada, Zvicër dhe Jordani.

Duke qenë se vlerësojmë lartë bashkëpunimin me partnerët tanë strategjik dhe synimi ynë është anëtarësimi në NATO, si pjesë e Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës kemi ofruar tre pako të mbështetjes ushtarake ndërsa në kuadër të këtij grupi u anëtarësua në Koalicionin e Deminimit që udhëhiqet nga Letonia.

Sa i përket aspektit të paraqitjes ndërkombëtare të Kosovës, theksoj se Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim është duke korrur suksese të jashtëzakonshme. Kjo qendër ka trajnuar qindra pjesëtarë të shteteve partnere si: Shqipëria, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Hungaria, Jordania, Malta, Maqedonia Veriore, Irlanda, Portugalia, Turqia, ndërsa me trajnimin e pjesëtarëve të Holandës filluam etapën e re të ofrimit me pagesë të trajnimeve në QNTKSH.

Pra, me punë të përkushtuar kemi arritur që objektivat e Fazës së Dytë të PGJT-së t'i përmbushim madje t'i tejkalojmë.

Në aspektin legjislativ gjatë kemi miratuar konceptin e Mbrojtjes Gjithëpërfshirëse. Duke marrë parasysh se viteve të fundit strategjia e luftës dhe interferimit në shtete me qëllim destabilizmin ka ndërruar dukshëm duke u bërë më hibride se kurrë, sulmet kibernetike janë çdo herë e më të shpeshta hapëm Qendrën Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike.

Synimi ynë është që përmes kësaj Qendre të trajnojmë institucionet e sigurisë t'i bëjnë ballë çdo sulmi të kësaj natyre.

Ajo që mund të them me siguri të plotë është se FSK posedon të gjitha kapacitetet e nevojshme për të garantuar siguri për qytetarët dhe mbrojtje të territorit të Republikës së Kosovës.

**Ejup Maqedonci,**  
**Ministër i Mbrojtjes**

## Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe sigurisë gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024, në Ministri të Mbrojtjes, u zhvilluan një sërë takimesh të rëndësishme diplomatike dhe zyrtare, duke forcuar lidhjet ndërkombëtare dhe bashkëpunimin me vendet partnere.

Ndër vizitat më të rëndësishme të vitit të kaluar janë pritja e ministrit të Mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë, Boris Pistorius, si dhe ceremonia zyrtare me ministrin e Mbrojtjes së Italisë, Guido Crosetto. Po ashtu, vizita e ministrit të Mbrojtjes së Kroacisë, Ivan Anusic, dhe ceremonia zyrtare në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes ishte një tjetër ngjarje e rëndësishme. Gjatë vitit, ministri Ejup Maqedonci u takua edhe me Shefin e Departamentit për Marrëdhënie me Jashtë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë, gjeneral brigade Omer Nafiz Gulmezoglu, dhe me të dërguarin e Posaçëm të Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Lord Stuart Peach.

Ndër takimet tjera të rëndësishme përfshihet ai me shefin e Operacioneve në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Turqisë, gjeneralmajor Subutay Ada , dhe vizita e ministrit të ri të Mbrojtjes së Shqipërisë, Pirro Vengu, i cili ishte i shoqëruar nga delegacioni i tij. Pritja e Ndihmës Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për Operacione, Thomas Goffus, dhe takimi me Zëvendës Ndihmës Sekretaren e Përgjithshme të NATO-s për Operacione, Burcu San, gjithashtu bënë pjesë në agjendën e ministrit Maqedonci. Gjithashtu, ai Komandantin e Forcave të Përbashkëta të NATO-s në Napoli, Admiralin Stuart B. Munsch, së bashku me Komandantin e ri të KFOR-it, Gjeneral Major Enrico Barduani. Për më tepër, ministri Maqedonci priti ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, Yaşar Güler dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Turke, Gjeneral Metin Gurak. Në fund, vizita zyrtare e Ministrit të Mbrojtjes së Letonisë, Andris Sprūds, ishte një tjetër ngjarje e rëndësishme gjatë këtij viti.

Në këto takime, u diskutuan tema të ndryshme që lidhen me sigurinë, sfidat dhe arritjet, si dhe forcimin e bashkëpunimit të Kosovës me NATO-n dhe vendet partnere.



## Aktivitetet Ndërkombëtare dhe takimet kryesore të Ministrit të Mbrojtjes brenda vitit

Gjatë vitit 2024, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, zhvilloi një sërë udhëtimesh dhe takimesh të rëndësishme jashtë vendit. Në fillim të vitit, me ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Finlandës, ai qëndroi në Finlandë ku u prit nga ministri i Mbrojtjes, Antti Hakkanen. Në Forumin e Sigurisë së Budapestit, Maqedonci takoi homologun e tij hungarez, Kristóf Szalay-Bobrovniczky.

Një tjetër arritje e rëndësishme ishte nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit me Ministrin e Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, Leo Docherty. Kjo marrëveshje synon përmirësimin e bashkëpunimit bilateral në fushën e mbrojtjes dhe mbështetjen e integritit të Kosovës në NATO. Gjatë Forumit të Sigurisë së Varshavës, ministri Maqedonci dhe kryeministri Albin Kurti takuan Ndhmës Sekretaren e Mbrojtjes së SHBA-së, Celeste Wallander dhe Ambasadorin Michael Carpenter, ku theksuan rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në NATO.

Në Katar, Ministri Maqedonci pati takime të frytshme me drejtuesit e Qatar Military Industry – Barzan Company dhe me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Mbrojtjes së Katarit, Khalid bin Mohammed Al Attiyah, për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit në industrinë e mbrojtjes.

Ministri Ejup Maqedonci mori pjesë gjithashtu në Forumin e Kartës së Adriatikut (A5), ku u diskutuan tema të rëndësishme të sigurisë rajonale dhe bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Për më tepër, ministri Maqedonci, së bashku me Presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe Komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, morën pjesë në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë në Halifax, Kanada, me ftesë të Ministrit të Mbrojtjes Kombëtare të Kanadasë, Bill Blair.

Gjithashtu, zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Syla, në muajin korrik qëndroi për vizitë zyrtare në Mbretërinë e Bashkuar me ftesë të Air Vice Marshal Nigel Maddox CBE. Me këtë rast, delegacioni nga MM dhe FSK vizituan bazën e Forcave Mbretërore Ajrore, Swanwick, për t'u njohur me sistemin e komandës dhe kontrollit ajror të Britanisë së Madhe.



## Kosova anëtar i asocuar i Asamblesë Parlamentare të NATO-s

Nga data 27 maj, Asambleja Parlamentare e NATO-s i ka dhënë Asamblesë së Republikës së Kosovës statusin e anëtarit asociuar të NATO-s. Si rezultat, Kosova tani ka privilegjin të propozojë dhe japë kontribut në çdo çështje që trajtohet nga Asambleja e NATO-s.

Ky vendim e afron Kosovën një hap më pranë anëtarësimit të plotë në Asamblesë Parlamentare të NATO-s, një zhvillim që padyshim do të ndikojë në stabilitetin e Ballkanit.



## Kosova zyrtarisht pjesë e Koalicionit të Deminimit për Ukrainën

Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, së bashku me ministrin e Mbrojtjes të Lituanisë, Laurynas Kasčiūnas, në Bruksel kanë nënshkruar marrëveshjen e përbashkët, sipas të cilës Kosova edhe zyrtarisht është pjesë e Koalicionit të Deminimit për Ukrainën.

Me këtë, Kosova është bërë shteti i 17-të anëtar i këtij koalicioni, që ka për qëllim ofrimin e mbështetjes për Ukrainën, përmes ofrimit të trajnimit në fushën e deminimit, zotim ky që është dhënë si pjesë e Grupit të Kontaktit për Ukrainën.

Gjithashtu, si pjesë e Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, Republika e Kosovës ka dhuruar donacion gjithsej 30 automjete taktike dhe jo taktike ndihmë për forcat e armatosura ukrainase.

Me këtë rast, u bë një hap të rëndësishëm në përfaqësimin e Kosovës dhe rolin e saj në sigurinë globale.



## FSK i bashkëngjitet Operacionit Interflex për trajnimin e ushtarakëve ukrainas

Në janar të vitit 2024, në Ministrinë e Mbrojtjes u mbajt ceremonia e nisjes së Kontingjentit të FSK-së në Operacionin INTERFLEX, realizuar në koordinim me Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen dhe përgatitjen e personelit ushtarak të Ukrainës.

Kontingjenti i dytë i FSK-së përfundoi me sukses periudhën gjashtëmujore në operacionin "Interflex" dhe u kthye në Kosovë në muajin dhjetor. Ata ishin integruar në njërën nga dy kompanitë britanike në Njësinë e Ofrimit të Trajnimeve, duke mbështetur planifikimin dhe ofrimin e trajnimeve për ushtarakët nga Forcat e Armatosura të Ukrainës. Gjatë këtij operacioni, ekipi i FSK-së demonstroi aftësi të larta ushtarake dhe disiplinë të fortë, duke kontribuar në ndërtimin e kapaciteteve dhe rritjen e sigurisë globale. Pjesëmarrja në Operacionin "Interflex" përforcoi angazhimin e Kosovës për paqe dhe stabilitet ndërkombëtar, si dhe për bashkëpunim të ngushtë me aleatët e saj.



## Republika e Kosovës dhe Republika e Turqisë nënshkruajnë Marrëveshje Ushtarake Kornizë

Republika e Kosovës dhe Republika e Turqisë në janar kanë nënshkruar Marrëveshje Ushtarake Kornizë me anë të së cilës pritet thellimi i bashkëpunimit ushtarak në shumë drejtime. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje u bë në Turqi në mes ministrit të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci dhe ministrit të Mbrojtjes Kombëtare të Turqisë, Yaşar Güler.

Shkëmbimi i personelit ushtarak, shkollimet, trajnimet e përbashkëta, investimi në industrinë e mbrojtjes si dhe trajtimi shëndetësor i pjesëtarëve të FSK-së në Turqi, ishin disa nga çështjet të cilat ministrat diskutuan, e që përmes marrëveshjes së nënshkruar i hapet rrugë procesit për realizimin e tyre.



## Marrëveshje historike mes Kosovës dhe Gjermanisë për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

Komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Bashkim Jashari dhe Shefi i Mbrojtjes së Gjermanisë, Gjeneral Carsten Breuer, më 17 dhjetor nënshkruan një marrëveshje të rëndësishme në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Marrëveshja e nënshkruar siguron përkrahjen e Gjermanisë për Kosovën në ofrimin e mbështetjes politike, ushtarake dhe ligjore për FSK-në, në mbështetje të pjesëmarrjes së saj në organizata ndërkombëtare. Gjithashtu, marrëveshja detajon fushat e bashkëpunimit, duke përfshirë stërvitje, trajnime, pjesëmarrje në organizata ndërkombëtare, mbështetje teknike dhe logjistike, si dhe shumë fusha të tjera me interes të përbashkët.



## FSK tregon sukses të lartë në ushtrimin “EFES 2024” në Turqi

Kontingjenti i FSK-së u paraqit me sukses të lartë në ushtrimin ushtarak “EFES 2024” në Izmir, Turqi. Ushtrimi përfshiu 45 shtete, mbi 12 mijë trupa dhe armatimin më modern të industrisë së mbrojtjes së Turqisë. Delegacioni nga Kosova, përfshirë zëvendësministrin e parë të MM-së, Shemsi Syla dhe gjeneral brigade, Hysen Dreshaj, përfaqësoi shtetin tonë.

Në përmbylljen e ushtrimit morën pjesë presidenti Erdogan dhe delegacione të larta nga shtetet pjesëmarrëse. FSK-ja demonstroi përgatitje profesionale, bashkëpunim me forcat komando turke dhe realizoi objektivat e ndërlikuara me sukses. Delegacioni gjithashtu vizitoi panairin e armatimit të kompanive turke dhe zhvilloi takime me personalitete të rëndësishme të industrisë së mbrojtjes.



## Konferenca Ndërkombëtare “FSK dhe Partnerët 2024” forcon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe sigurinë rajonale

Konferenca vjetore ndërkombëtare “FSK dhe Partnerët 2024”, e organizuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, mbledhi përfaqësues të lartë të Ministrisë, ambasadorë dhe atashë të mbrojtjes nga vende partnere. Fjalimet e zëvendësministrit të Mbrojtjes, Shemsi Syla, komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, dhe të tjera nga ambasadorë dhe përfaqësues të NATO-s, theksuan bashkëpunimin ndërkombëtar dhe sukseset e përbashkëta. Konferenca gjithashtu përfshiu prezantime tematike nga oficerë të lartë të FSK-së dhe atashë ushtarakë nga vende partnere, duke trajtuar arritjet dhe sfidat në sigurinë rajonale dhe globale.



## Kosova dhe Turqia me kontratë për ngritjen e fabrikës së municioneve

Kryeministri i Republikës së Kosovës ka nënshkruar një kontratë me prodhuesin shtetëror turk "Makine ve Kimya Endüstrisi", duke vendosur themelet për ngritjen e industrisë së mbrojtjes në vend. Në kuadër të kësaj kontrate, do të vihet në funksion një fabrikë municionesh që do të prodhojë municione të kalibrave të ndryshëm, duke respektuar standardet e NATO-s. Kontrata përfshin furnizimin me makineri prodhuese, trajnimin e stafit vendas, mirëmbajtjen e pajisjeve, dhe instalimin e sistemeve moderne për testimin e cilësisë dhe kalibrimin. Ky projekt përfaqëson një hap të rëndësishëm në fuqizimin e kapaciteteve mbrojtëse të Kosovës.



## Arritjet në dokumentet strategjike të Mbrojtjes së Kosovës për 2024

Departamenti për Politika dhe Strategji në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës ka pasur një vit të ngarkuar me shumë aktivitete dhe arritje të rëndësishme. DPS ka monitoruar dhe harmonizuar dokumentet strategjike dhe politikat e mbrojtjes, duke përgatitur dhe finalizuar disa dokumente të rëndësishme si: prioritetet e Ministrit të Mbrojtjes për vitin 2024 dhe 2025, Plani Afatgjatë Zhvillimor dhe Deklarata e Politikave për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2025-2027.

Në fushën e zhvillimit dhe analizës, DPS ka përgatitur 14 punime me analiza dhe rekomandime, duke përfshirë tema të rëndësishme si kërcënimet e Ruisë ndaj NATO-s dhe BE-së, avancimin e statusit të Kosovës në NATO, shpenzimet ushtarake globale, dhe raportet e NATO-s. Punimet përfshijnë gjithashtu analiza mbi konfliktet në Lindjen e Mesme, garën për armatim në Ballkan dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në domenin ushtarak.

DPS ka vazhduar të monitorojë dhe harmonizojë zbatimin e politikave të mbrojtjes me dokumentet strategjike, duke kontribuar në sigurinë dhe mbrojtjen e vendit. Përmes punimeve analitike dhe bashkëpunimit me institucione të ndryshme, DPS ka luajtur një rol kyç në zhvillimin dhe implementimin e politikave të mbrojtjes dhe strategjive të sigurisë në Kosovë.

Në vazhden e takimeve në kuadër të Kartës së Adriatikut (A5), nga data 19-21 nëntor 2024, drejtori i Departamentit për Politika dhe Strategji, Azem Smajli, ka marrë pjesë si vëzhgues, në konferencën e nivelit të Drejtorëve për Politika të Mbrojtjes.

Kjo pjesëmarrje tregon gatishmërinë e MM-së dhe FSK-së për tu bërë pjesë e kësaj iniciative, ku do të rriste sigurinë e popujve në rajon, e në veçanti do të ngritë zhvillimin edhe profesionalizmin e institucionit tonë.



## Roli Strategjik i DPV në Zhvillimin e Politikave të Mbrojtjes dhe Sigurisë

Përmes hartimit të dokumenteve strategjike dhe dhënies së opinionit profesional dhe rekomandimeve, Departamenti për Planifikim dhe Vlerësim ka luajtur një rol kyç në zhvillimin dhe implementimin e politikave të mbrojtjes dhe strategjive të sigurisë gjatë vitit 2024. Një vit plot arritje dhe përkushtim ndaj sigurisë dhe zhvillimit strategjik të vendit.

Gjithashtu, në vitin e kaluar DPV ka realizuar një sërë arritjesh të rëndësishme, duke kontribuar në hartimin dhe monitorimin e planeve strategjike për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, është koordinuar hartimi i Planit të Ministrisë për vitin 2025, duke u bazuar në objektivat strategjike vjetore të Ministrisë të Mbrojtjes si dhe është hartuar Plani i Punës për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me Programin Qeveritar 2021-2025.



## Avancimi i diplomacisë së mbrojtjes dhe integriteteve ndërkombëtare të Kosovës

Gjatë vitit 2024, Ministria e Mbrojtjes ka arritur një objektiv të rëndësishëm në zgjerimin e rrjetit diplomatik të atashëve të mbrojtjes. Me miratimin e kërkesës së Kosovës për akreditimin e një atashëu të mbrojtjes të FSK-së në Mbretërinë Hashemite të Jordanisë, rrjeti i diplomacisë ushtarake është zgjeruar ndjeshëm.

Aktualisht, Kosova mbulohet nga atashë të mbrojtjes nga 12 vende, katër prej tyre rezidentë dhe tetë jo-rezidentë. Shtatë atashë të mbrojtjes rezidentë janë vendosur në SHBA, Britani të Madhe, Holandë, Gjermani, Kroaci, Shqipëri dhe Turqi. Gjithashtu, janë dërguar atashë jo-rezidentë për Slloveninë, Kanadanë dhe nga ky vit, edhe për Konfederatën Zvicerane. Në fund të vitit 2024, u përzgjedhën atashë të rinj në Itali dhe Japoni.

Për herë të parë, një Përfaqësues Ushtarak i FSK-së u dërgua në Komandën e Ushtrisë Amerikane për Evropë dhe Afrikë (USAREUR-AF) dhe në qendrën RACVIK në Kroaci. Kosova vazhdoi të koordinojë veprimet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, përfshirë një takim të përbashkët mes Kosovës dhe Shqipërisë. Janë aprovuar dhe nënshkruar planet bilaterale për vitin 2025 me SHBA-lowa, Turqi, Itali, Austri dhe Gjermani, ndërsa draftet finale janë përcjellë te vende të tjera partnere.

Në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar, gjithashtu duhet theksuar se janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 15 shtete, ndërsa në proces të dakordimit për MoU janë me Republikën Çeke, Bullgarinë dhe Finlandën.



## Rritje e buxhetit për Ministrinë e Mbrojtjes në vitin 2025 në rreth 208 milionë euro

Sipas Qarkores Buxhetore 2025/02 me kufijtë final buxhetor, buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2025 në vlerë prej 207,940,243.00 euro.

Realizimi preliminar i buxhetit për Ministrinë e Mbrojtjes për periudhën janar- dhjetor 2024 është në vlerë 169,791,544.42 euro apo 96.93% me buxhetin në total 175,175,119.59 euro.

Buxheti rekord ka përshpejtuar ndjeshëm zhvillimin e ushtrisë sonë, duke përmirësuar kapacitetet në tri aspekte kyçe: arsenalin ushtarak, rritjen e numrit të personelit dhe ndërtimin profesional të tyre përmes trajnimeve të avancuara.



## Përkushtimi për komunikim transparent dhe rritja e besueshmërisë së FSK-së

Përkushtimi maksimal i ZMP-së ndaj komunikimit profesional dhe transparent me publikun ka vazhduar me intensitet të lartë edhe gjatë vitit 2024. Ministria e Mbrojtjes ka paraqitur të gjitha aktivitetet publike dhe mediale me një angazhim të jashtëzakonshëm dhe profesionalizëm të lartë. Kjo transparencë ka qenë çelësi për të mbajtur qytetarët të informuar dhe të angazhuar me zhvillimet dhe reformat e rëndësishme në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Bazuar nga analiza vjetore e aktiviteteve të ZMP-së, viti 2024 ka qenë një vit i suksesshëm për Zyrën për Marrëdhënie me Publikun në përpjekjet e saj për të komunikuar në mënyrë efektive dhe transparente me publikun.

Me organizimin e konferencave për media, postimet në rrjetet sociale, komunikatat për media dhe videot, si dhe fushatat e rekrutimit, ZMP ka dëshmuar përkushtimin dhe profesionalizmin e saj në çdo aspekt të komunikimit publik, të cilat kanë ndikuar në vazhdimin e ndërtimit të një imazhi të qëndrueshëm dhe pozitiv të Ministrisë dhe FSK-së.

Në një sondazh për Ballkanin Perëndimor të kryer nga Instituti Ndërkombëtar Republikan, 67% e të anketuarve e vlerësuan Forcën e Sigurisë së Kosovës si institucionin më të besueshëm në Kosovë. Qytetarët e Republikës së Kosovës shprehën besim të plotë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ky rezultat reflekton përkushtimin e anëtarëve të ushtrisë sonë, të udhëhequr nga parimet e transparencës dhe përgjegjësisë së plotë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës në përmbushjen e objektivave të tyre.

Sipas këtij sondazhi, Forca e Sigurisë së Kosovës gëzon besueshmërinë më të madhe nga të gjitha ushtritë e shteteve të Ballkanit Perëndimor.



## Suksesi dhe efikasiteti në organizimin e aktiviteteve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së

Me efikasitet të plotë, Njësia e Protokollit ka ndjekur një program të ngjeshur aktiviteteve, duke përfshirë pritjet dhe organizimin e vizitave të autoriteteve ndërkombëtare në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK. Njësia ka marrë pjesë aktive në organizimin e ceremonive të rëndësishme si: zbarkimi i kontingjentit për INTERFLEX, përgatitja e programit dhe agjendës së aktiviteteve për 16-vjetorin e Pavarësisë dhe përirimi i Qendrës Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike, etj. Në pjesën e dytë të vitit, Njësia e Protokollit ka marrë pjesë në Konferencën FSK dhe Partnerët 2024, duke bërë përgatitjet e nevojshme për pjesëmarrjen e liderëve nga MM dhe FSK dhe ambasadorëve të huaj. Vizitat ushtarake dhe ceremonia e pranimit-dorëzimit të detyrave nga drejtori i NALT-it kanë qenë gjithashtu aktivitete kryesore gjatë vitit.



## Përparime të mëdha në deminimin humanitar në Kosovë

Përgjatë vitit 2024, operacionet e deminimit humanitar kanë pastruar një sipërfaqe totale prej 1,557,638 metrash katrorë dhe kanë eliminuar 590 mjete eksplozive. Operacionet e deminimit në Kosovë kanë filluar më 18 mars dhe kanë përfunduar më 22 nëntor 2023. Njësitë e FSK-së kanë zhvilluar operacione në tri lokacione kryesore: Parku i Lirisë Ferizaj, Cvilen, dhe Murademë. Përveç pastrimit të zonave, FSK ka zhvilluar edhe operacionet e Eliminimit të Ordancës Eksplozive (EOD), ku është intervenuar në 321 raste dhe janë shkatërruar 158 mjete eksplozive, ndërsa janë kontrolluar në mënyrë sipërfaqësore 453,315 metra katrorë.

Me një vit plot arritje dhe angazhim, Qendra Koordinuese për Deminim ka treguar se është e përkushtuar për të mbrojtur jetët e qytetarëve dhe për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të pastër nga minat dhe mjetet e tjera eksplozive.

QKD ka bashkëpunuar ngushtë me FSK-në, KFOR-in dhe organizata ndërkombëtare si Norëegian People Aid dhe Halo Trust.

Gjatë vitit 2024 është miratuar plani strategjik i veprimit ndaj minave në Republikën e Kosovës 2025 -2030, i cili paraqet orientimin strategjik të programit të aksionit ndaj minave të Kosovës nga janari 2025 deri në dhjetor 2030.

Gjithashtu, edukimi për rrezikun nga minat ka luajtur një rol kyç në ndërgjegjësimin e publikut.



## Efikasiteti i Departamentit të Prokurimit dhe Kontratave gjatë vitit

Departamenti i Prokurimit dhe Kontratave në MM realizoi kërkesat në përputhje me ligjet dhe rregullat për Prokurimin Publik në Kosovë. Aktivitetet e planifikuara përfshinin 49 furnizime, 24 shërbime dhe 18 ndërtime. Procedurat u realizuan për 108 aktivitete, ndërsa disa kërkesa u rikthyen për plotësim. U nënshkruan gjithsej 82 kontrata dhe aktualisht ishin në proces 11 aktivitete të tjera. Gjithsej u nxorën 624 urdhër blerje me vlerë totale prej 91,880,240.84€ për periudhën nga 01.01.2024 deri më 24.12.2024.



## Iniciativa ligjore dhe marrëveshjet strategjike

Në kuadër të Programit Legjislativ të Qeverisë për vitin 2024, Departamenti Ligjor përgatiti projektligje për ratifikimin e marrëveshjeve ushtarake dhe për ndryshimin e ligjeve ekzistuese, të cilat u proceduan dhe miratuan nga Qeveria.

Pas miratimit të tri ligjeve kryesore për MM dhe FSK, sektori vazhdoi monitorimin dhe harmonizimin e akteve nënligjore me ligjet e reja, duke inicuar procedurat e ndryshimit të akteve përkatëse përfshira në planin legjislativ të vitit 2024. Një nga aktivitetet kryesore në vitin 2024 ishte hartimi i një koncept dokumenti për Ministrinë e Mbrojtjes, i cili propozonte një ligj të ri për të adresuar çështjet e paparapara nga ligjet ekzistuese. Ky dokument u procedua për miratim dhe u bart në objektivat e vitit 2025.

Gjithashtu, gjatë vitit 2024, Departamenti Ligjor u angazhua edhe në hartimin e koncept-dokumentit për komponentin Rezervë të FSK-së dhe për fushën e Inspektorit Gjeneral të FSK-së.



## Miratohet në qeverinë e Republikës së Kosovës Programi Kombëtar për Mbrojtjen Gjithëpërfshirëse

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Programin Kombëtar për Mbrojtjen Gjithëpërfshirëse i cili është hartuar duke marrë për bazë sisteme të ngjashme që aplikohen në vende të ndryshme të NATO-s dhe mundëson që institucionet qendrore dhe lokale dhe veçanërisht qytetarët e Republikës dhe organizatat e ndryshme jo-qeveritare të kenë rolin e tyre në sistemin e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit tonë.

Ky program synon që të ndërtojë reziliencën kombëtare në vendin tonë në mënyrë që shoqëria jonë të përgatitet të rezistojë, reagojë dhe rimëkëmbet në raste të fatkeqësive natyrore apo sulmeve të armatosura.



## Avancimi i të Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes dhe FSK, krahas ngritjes së kapaciteteve operacionale, i kushtojnë rëndësi të veçantë respektimit dhe avancimit të të drejtave të njeriut. Institucioni garanton kultivimin dhe zhvillimin e kulturës dhe identitetit të komuniteteve jo shumicë dhe ka përbushur obligimin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë vitit 2024, Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës ndërmoi përpjekje të rëndësishme për respektimin e të drejtave të njeriut dhe avancimin e barazisë gjinore. Me këtë rast, Ministria ka përfshirë barazinë gjinore në Strategjinë e Mbrojtjes dhe politikat e saj, duke e integruar atë në kurrikulat e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Rrjeti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore është funksionalizuar në të gjitha njësitë e MM dhe FSK-së dhe Qendra e Stërvitjes Bazike ka përfshirë barazinë gjinore në programin e trajnimit për rekrutët e rinj.

Në Ministrinë e Mbrojtjes, rreth 28 për qind e stafit janë gra dhe vajza, të cilat japin kontribut në të gjitha departamentet dhe njësitë. Në FSK, niveli i përfaqësimit të grave është rreth 10 për qind, me synim të rritjes së këtij numri në të ardhmen. Gratë ushtarake kontribuojnë në të gjitha strukturat e FSK-së.



## Strategjia dhe sukcesi në integrimin e komuniteteve jo-shumicë në Ministrinë e Mbrojtjes

Në vitin 2024, Njësia për Çështjet e Komuniteteve ka realizuar me sukses Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Jo-Shumicë, gjë që ka dëshmuar se është një mjet i fuqishëm për ndërtimin e një shoqërie më të integruar dhe më të bashkuar. Në Ministrinë e Mbrojtjes janë pranuar me sukses punëtorë të rinj nga komunitetet pakicë, duke rritur në këtë mënyrë diversitetin dhe përfshirjen në institucion. Kontributi i këtyre punëtorëve të rinj ka qenë i dukshëm në përmirësimin e funksionimit dhe efikasitetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK. Ky vit ka qenë një shembull i shkëlqyer i asaj që mund të arrihet kur institucioni dhe komunitetet bashkëpunojnë në mënyrë efektive për një të ardhme më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse.



## Përparimi i FSK-së në rritjen profesionale dhe modernizimin e pajisjeve

Në vitin 2024, Forca e Sigurisë së Kosovës ka bërë hapa të rëndësishëm në rritjen profesionale dhe modernizimin e pajisjeve. Një shembull i këtij progresi është përfshirja e dronëve Bayraktar në arsenalin e FSK-së, ndërsa është në proces të ekzekutimit të pagesave për blerjen e sistemit amerikan raketor anti-tank "Javelin".

Një arritje e rëndësishme gjatë këtij viti ishte emërimi i Bordit të Standardizimit dhe miratimi i Planit Vjetor të Standardizimit për vitin 2025. Po ashtu, Departamenti për Transformim, Modernizim dhe Standardizim (DTMS) ka hartuar dhe miratuar Rregulloren për Planifikim, Programim, Buxhetim dhe Ekzekutim (PPBE) më 2 korrik 2024, dhe ka formuar grupet punuese për implementimin e saj.

Në këtë mënyrë, DTMS ka luajtur një rol kyç në koordinimin, vlerësimin dhe mbikëqyrjen e procesit të transformimit, modernizimit dhe standardizimit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës sipas Planit Gjithpërfshirës të Tranzicionit (PGJT), duke u siguruar që FSK-ja të jetë e përgatitur dhe e pajisur me teknologjinë më moderne për t'u përballur me sfidat e së ardhmes.



## Në FSK gjatë vitit 2024 janë pranuar 346 rekrutë dhe në proces rekrutimi janë 390 kandidatë të tjerë

Në vitin 2024, gjenerata e parë e rekrutëve përfshiu 346 rekrutë. Ndërsa gjenerata e dytë prej 390 kandidatëve pritet të fillojë ekzaminimin mjekësor dhe trajnimin bazik pas vendimit nga ministri i Mbrojtjes.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka zhvilluar dhe realizuar aktivitetet në përputhje me objektivat strategjike dhe planin vjetor të punës. Detyrat përfshinin rekrutimin, kualifikimin, arsimimin, kompensimin dhe mbështetjen e personelit deri në lirim nga shërbimi.

### Statusi i Personelit

Ushtarak aktiv: 3,930 (78.69%), meshkuj 90.92%, femra 9.08%

Ushtarak rezervë: 115 (3.93%), femra 12.17%, meshkuj 87.83%

Kadet në shkollim: 135, femra 14.2%, meshkuj 85.18%

Staf civil në FSK: 114 (21.93%), femra 12%, meshkuj 78.07%

Staf civil në MM: 127 (59.06%), femra 33.07%, meshkuj 66.93%



## Arritjet vjetore të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së dhe Marrëveshja për Shkëmbim Kadetësh me Kanadanë

Gjatë vitit 2024, Qendra për Studime Universitare e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka pasur suksese të rëndësishme. Janë rekrutuar gjithsej 42 kadetë, nga të cilët 20 janë pranuar në QSU, pesë në Gjermani, tre në Turqi, dhjetë në Shqipëri, një në Kroaci, tre në Angli dhe një në West Point, SHBA. Aktualisht, 135 kadetë janë në proces shkollimi, përfshirë 63 në QSU, tre në Britani të Madhe, nëntë në Gjermani, katër në Kroaci, tre në SHBA, 25 në Shqipëri dhe 28 në Turqi.

Në dhjetor të vitit 2024, Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, nënshkroi Memorandumin e Bashkëpunimit për Shkëmbimin e Kadetëve ndërmjet Qendrës së Studimeve Universitare të FSK-së dhe Kolegjit Ushtarak Mbretëror Saint-Jean të Kanadasë. Kjo marrëveshje do të mundësojë shkëmbimin e ndërsjellë të kadetëve duke filluar nga semestri i dytë i vitit akademik 2024/2025, duke kontribuar kështu në zhvillimin e kadetëve të FSK-së dhe rritjen e ndërveprueshmërisë së tyre me kolegët nga Kanadaja.



## Departamenti për Menaxhimin e Karrierës dhe Verifikimin- Arritjet kryesore për vitin 2024

Gjatë vitit, departamenti Departamenti për Menaxhimin e Karrierës dhe Verifikimin ka realizuar procedurat e verifikimit për 77 zyrtarë dhe pjesëtarë të MM dhe FSK në AMIK, të ndarë sipas niveleve të klasifikimit: 5 zyrtarë për nivelet "Tepër Sekret", 53 zyrtarë për nivelet "Sekret" dhe 19 zyrtarë për nivelet "Konfidencial".

Departamenti përfundoi pastërtinë e figurës për 28 kandidatë për kadetë, të cilët e kaluan këtë proces. Për tetë kandidatë të tjerë që kishin kaluar pastërtinë e figurës më parë, janë përgatitur dhe nxjerrë vendimet për kalimin e pastërtisë së figurës.

Gjatë vitit, me shtetet partnere janë realizuar 141 trajnime, ku kanë marrë pjesë 537 pjesëtarë.



## Donacionet dhe forcimi i kapaciteteve të FSK-së

Gjatë vitit 2024, Ministria e Mbrojtjes ka pranuar një sërë donacionesh nga partnerë ndërkombëtarë dhe donatorë privatë, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve dhe pajisjeve të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Këto donacione përfshijnë pajisje të ndryshme të cilat janë të një rëndësie të madhe për operacionet dhe trajnimin e FSK-së.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhuruar pajisje të ndryshme për FSK-në, duke përfshirë mjete komunikimi, pajisje Hazmat dhe EOD, inventar për trajnim dhe administratë, si dhe pajisje për markim paletash, me një vlerë totale prej rreth 3.2 milionë dollarë, mbi 30 mijë euro dhe mbi 4 mijë funta.

Republika Federale e Gjermanisë ka dhuruar kamionë ushtarak për FSK-në, me një vlerë totale prej rreth 2.45 milionë euro.

Republika e Turqisë ka dhuruar pajisje "Vuran" për FSK-në, me një vlerë totale prej rreth 1.3 milionë dollarë.





## Inaugurimi i Qendrës Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike

Në muajin mars, në Kazermën e FSK-së, u mbajt ceremonia e inaugurimit të Qendrës Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike.

Kjo Qendër, e cila përbën një shtyllë të re rëndësishme të mbrojtjes së sigurisë së vendit, do të ofrojë trajnime me qëllim të ngritjes së ndërgjegjësimit për rreziqet në fushën e sigurisë kibernetike, do të përmirësojë aftësitë profesionale dhe të ndihmojë në ngritjen e niveleve të sigurisë kibernetike të institucioneve qeveritare, operatorëve të shërbimeve esenciale dhe ofruesve të shërbimeve digjitale, për të arritur kapacitetet për mbrojtjen e infrastrukturës kritike në vend.

Kurrikula për Qendrën Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike, që përbën një element thelbësor në zbatimin e Strategjisë kombëtare të sigurisë kibernetike, është hartuar në mbështetje nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar dhe është implementuar nga Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë (DCAF) me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtar.



## Bashkëpunimet e MM-së dhe FSK-së për ngritjen e shërbimeve mjekësorë

Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, janë organizuar aksionet e dhurimit vullnetar të gjakut në MM dhe FSK, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme me produktet e gjakut dhe mbështetje logjistike për Qendrën. Në janar, Departamenti i Mjekësisë ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet MM dhe Odës së Farmacistëve të Kosovës.

Në rrafshin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën mjekësorë, ka vazhduar dërgimi i pacientëve për trajtim mjekësor në GATA-Ankara në Turqi. Ndërsa në kuadër të marrëveshjes me Qendrën Psiko Sociale për Trauma-Terapi, pesë pjesëtarë të MM-së dhe FSK-së kanë ndjekur një trajnim dyvjeçar për trauma-terapi.



## Përmirësimi i Sigurisë dhe Informacionit përmes projekteve të sigurisë për MM dhe FSK

Për të implementuar politikat e sigurisë dhe realizuar objektivat e Ministrit të Mbrojtjes për vitin 2024, Drejtoria e Inteligjencës dhe Sigurisë ka punuar në hartimin, rishikimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike për fushën e inteligjencës dhe sigurisë. Niveli i sigurisë dhe informacionit është përmirësuar përmes projekteve të sigurisë për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK ndërsa bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe inteligjencës ka qenë i vazhdueshëm. Janë nënshkruar marrëveshje bilaterale dhe janë zgjeruar kontaktet me tri shtete të reja, duke përfshirë takime me partnerët nga Shqipëria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Bullgaria, Gjermania, Austria dhe Sllovenia.



## Përmirësimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes

Gjatë vitit 2024, është përmirësuar dhe avancuar korniza ligjore në fushën e mbrojtjes, përmes hartimit të dy udhëzimeve dhe konceptit për veprimtarinë e Inspektorit Gjeneral. Transparenca dhe llogaridhënia institucionale janë rritur për të siguruar integritet dhe kredibilitet përmes hartimit të planeve dhe raporteve vjetore, përfshirë 12 plane mujore, planin për PKZH-së 2025-2027 dhe raportet monitoruese e inspektuese.

Përmirësimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë inspektimet e papritura dhe hetimet për vlerësimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga Inspektori Gjeneral dhe Ministri i Mbrojtjes, ka qenë një komponent thelbësor. Bashkëpunimi ndërinstitucional ka vazhduar me institucione të tjera dhe janë krijuar njësi të reja me fokus në monitorimin e rekomandimeve lidhur me gatishmërinë operacionale të FSK-së.

Modernizimi dhe standardizimi janë arritur përmes inspektimeve lidhur me zbatueshmërinë e programeve të mbrojtjes, duke parandaluar abuzimet dhe keq menaxhimet. Inspektorati Gjeneral ka thelluar partneritetin me SHBA dhe ka zgjeruar bashkëpunimin bilateral për kontribut në operacionet ndërkombëtare dhe shkëmbimin e eksperiencave në inspektorat.



## Menaxhimi efektiv i dokumenteve dhe arkivimit në Ministrinë e Mbrojtjes

Departamenti për Menaxhimin e Dokumenteve dhe Arkivit ka realizuar me sukses të gjitha aktivitetet e planifikuara dhe ato që janë shfaqur me kërkesa shtesë. Në Librin Kryesor të Protokollit janë trajtuar 4877 dokumente dhe 4011 dokumente në Librin e Protokollit në Hyrje. Zyra për Menaxhimin e Informacionit të Klasifikuar ka trajtuar 713 dokumente, duke çuar totalin në 9601 dokumente. Zyra për Përkthim dhe Lekturim ka realizuar 53 përkthime simultane dhe 249 dokumente të përkthyer me gjithsej 1343 faqe, si dhe ka lekturuar 41 dokumente me gjithsej 659 faqe.







Publikues:  
Drejtoria për Politika të Mbrojtjes  
Departamenti për Planifikim dhe Vlerësim  
Zyra për Marrëdhënie me Publikun